

2019

Zyra Komunale për
Komunitete dhe Kthim-
Rahovec

Shef I Zyres ,
Lendrit Qeli - Jur.Dipl



RAPORTI VJETOR 2019

**“SFIDAT DHE TË ARRITURAT E
KOMUNITETEVE JO-SHUMICË, TË
ZHVENDOSURVE DHE
PËRSONAVE TË RIATDHESUAR NË
KOMUNËN E RAHOVECIT”**


1. HYRJE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim , e emertuar shkurt ZKKK, duke u bazuar në rregulloren Nr. 02/2010 , gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2019** (një vjeqare) ka kryer punë të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejt në promovimin , mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, qasjen e barabartë të tyre në shërbimet publike , etj .

Poashtu në bazë të rregulloreve dhe obligimeve të saja , ka rezultuar në bashkërendimin e procesit të kthimit të personave të zhvendosur si dhe riintegrit të personave të riatdhesuar , në mënyrë që kthimi dhe riintegrimi të jenë sa më të qëndrueshëm , duke ju përshtatur edhe planit të punës së saj të miratuar për gjat vitit 2019.

PARAQITJA E POPULLSISË SIPAS ETNICITETEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



VENËBANIMET E KOMUNITETEVE JO SHUMICË.

Sa i përket përfshirjes së Venbanimeve të komuniteteve Jo shumicë , Numri më I madh I banorëve nga Komuniteti **Serbë** jetojnë në fsht.Hoqë e Madhe , dhe në pjesën e Epërm të Rahovecit .

Ndërsa komuniteti **Rom ,Ashkali , Egjiptian, Boshnjak** në komunën e Rahovecit , jetojnë në vendbanime urbane dhe rurale si: Lagja e Epërm-Rahovec , Fsht. Çifllëk , Dobridol , Sanovc , Ratkovc, Radostë , Gexhë, Xërxë , Fortesë , Bërjang, Celin , Krushë e Madhe , Hoqë e Vogël , Brestovc , Zoçishtë , Opterushë, etj .

GJENDJA E PËRGJITHSHME E ZKKK-së dhe KOMUNITETEVE JO SHUMICË

Edhe pse me vëshirësi të mëdha financiare përgjatë vitit 2019, Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim - ZKKK , ka menaxhuar buxhet prej 30,000 € Invenstime Kapitale , 24.500 € , Mallra dhe Shërbime , dhe rreth 60.000 € Paga dhe Meditje .

ZKKK- është munduar të intervenoj në përmisimin e gjendjës në përgjithsi së komuniteteve jo shumicë në Komunën e Rahovecit , ku në bazë të vlersimit të gjendjës së tyre në bashkëpunim dhe në partneritet me organizata Vendore dhe Nderkombetare ka intervenuar në :

- **Punësim ,**
- **Strehim & Banim**
- **Ndihma Humanitare/Ushqimore dhe Veshembathje ,**
- **Mbështetje me materiale dhe paisje shkollore për Fëmijët ,**
- **Ndriçimit Publik dhe**
- **Infrastrukturës Rrugore etj .**

Përfituesit nga rradhet e komuniteteve jo-shumicë , kanë qenë një numër I konsiderueshëm I tyre nga vendëbanimet e ndryshme ku jetojnë ata si në : Lagjën e Epërm të Rahovecit , Fshat : Hoqë e Madhe , Krushe , Dobidol , Xërxe , Gexë , Senoc , Ratkoc, Radostë , Zoqishtë etj) .

SITUATA SOCIO-EKONOMIKE E KOMUNITETEVE :

Për situatën e rëndë socio-ekonomike , të gjeturat tona si ZKKK-ë, kanë përputhshmeri edhe me raportet/vlersimet e ngjajshme që janë bërë edhe nga faktorët Vendor dhe Ndërkombetarë, si Institucioni I **Avokatit të Popullit** , ku ky institucion shpesh herë ka kërkuar që Shteti ynë të ketë kujdes ndaj gjendjës së varferisë , e sidomos ndaj komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian , ku kjo kategori e komuniteteve ende bëjnë pjesë si grupe të marginalizuara dhe me qasje më të mangët në gjithëpërfshirje . Ndërsa vlersimet nga ata ndërkombetare me mission në Kosovë si OSCE , UNMIK , UNDP , kanë nxerrë raporte periodike dhe kanë intervenuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale rreth infrastrukturën ligjore për ndihmë ndaj këtyre kategorive , dhe lehtësimin e mundësisë së punimit përmes Panaireve të Punës në nivel Vendi .

Nese I rreferohemi shifres së përgjithshme të papunësisë në nivel Vendi me ç’rast thuhet se shkalla e papunësisë së Kosovë është nga 35-40% , gjendja sociale e komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian kap shkallën prej mbi 75-80 % të tyre me gjendje të rëndë sociale , dhe me mbi 55% varferi të skajshme .

Duhët pajtuar , mbi këtë gjendje faktorë mbetën edhe segmentët të tjera , që janë pjesë përbërse të kësaj situate të rënduar , si : Niveli I dobët I shkollimit , Braktisjes së Shkollimit në Fëmijeri të hershme (posaqëesisht tek vajzat) , Mungesa e shkollimit në Gjuhën amtare Rome për komunitetin Romë , Martesat e Hershme nën moshën 16 vjeqare , Banimi dhe Strehimi I dobët etj .

GJENDJA NË PUNSIM :

-Duke ju referuar situatës dhe gjendjës së komuniteteve jo shumicë , në Komunën e Rahovecit, problemet më të theksuara që ata ballafaqohen, mbetet sfida dhe prioritet i ynë për të intervenuar, trajtuar dhe zgjidhur çështjet , që sidomos lidhen me shkallën e lartë të tyre të **Papunësisë** . Ky fenomen , që nuk prek vetëm gjendjen e komuniteteve jo shumicë , shkallë të lartë të papunisë vërehet edhe tek komuniteti shumicë Shqiptar , por tek komunitetet jo shumicë sidomos ata të marginalizuara (rom , ashkali dhe egjiptian) vërehet një shkallë shumë më e lartë . Si pasojë e shkallës së lartë të punësimi , problemet e papunësisë derivojnë nga shumë faktorë të tjerë që i atakojnë komunitetet jo shumicë veqenarisht , që çoftë në menyrë direkte apo indirekte , rrjedhimisht rritin shkallën e pamundësisë në Kosovë dhe vendin tonë .

Faktorët kryesor që pamundësojnë punësimin e këtyre komuniteteve , për të qenë të aftë të jetojnë në menyrë të pavarur , është edhe pengesa kryesore e përgatitjes shumë të vogël apo e limituar profesionale e tyre , në menyrë që participimi i tyre në tregun e punës të jetë në nivel .

Vlene të theksohet , që nuk ka pasur edhe iniciativa të mjaftushme nga **Qendra e Aftësimi Profesional në Prizren ose Gjakovë** , për nxitje apo mundësi të aftësimi profesional të këtyre komuniteteve , me qëllim të informimit dhe promovimit të programeve të tyre të akredituara .

Por në anën tjetër të gjeturat nga hulumtimet dhe vlersimet në teren thonë që , ka pasur edhe interesimi të dobët nga vetë pjestaret e komuniteteve në këtë drejtim , të paktë janë ata që interesohen për të marrë informata bazë për një zeje dhe profesione sipas programeve të akredituara në dispozicion .

Gjatë vizitave në teren , pasoja e mos interesimit të kë pjestarëve të komunitete është justifikuar edhe me distancën prej rreth 22 KHM , sa Gjeografikisht ka komuna ynë prej Gjakovës dhe Prizrenit , e cila mbetet si sfida për aftësimin profesional të tyre në këtë drejtim .

PUNËSIMI I KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË INSTUTICIONE PUBLIKE:

Si pasojë e shkallës së lartë të papunisë për pjestarët e Komuniteteve Romë , Ashkali dhe Egjiptian , nuk mbeten problematike vetëm kategoritë që kanë shkollim të pa mjaftushëm apo që kanë ndërprerë shkollimin primar dhe obligativ!

Hic më mirë në këtë segment nuk janë edhe ata që kanë përfunduar shkollimin e Mesëm apo Universitar në Komunën e Rahovecit .

Edhe pse numerikisht numri i atyre që kanë përfunduar Shkollimin e Mesëm apo Universitar janë të paktë dhe mund të numrohën në gishta të dorës , në bazë të informatave që posedon ZKKK-ja, aktualisht janë rreth **10 individ** nga Komunitetët Rom , Ashkali dhe Egjiptian që kanë përfunduar Shkollim të Mesme , dhe 3 (tre) prej tyre që kanë diplomuar në shkollim të lartë Universitarë. Gjendja e punësimi momental në teritorin e Komunës së Rahovecit në shërbimin civil-publik janë vetem 2 (dy) të punësuar : 1 (një) pjestarë i komunitetit Egjiptian në Arsim (pedagog i ciklit të ulët) , dhe 1 (një) pjestarë i komunitetit Egjiptian në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim ZKKK .

Shumë më mirë qëndron gjendja tek komuniteti Serbë në këtë drejtim , ky komunitet ka të punsuar rreth 10 individ në digastere të ndryshme institucionale publike kryesisht në Komunë .

Kur jemi tek segmenti I punsimit , Komunitetet jo shumicë janë të angazhuar edhe në institucionet e drejtësisë , në Gjykatën Themelore të Gjakovës dega në Rahovec , janë të punsuar 1 (një) pjestarë I Komuniteti Ashkali dhe 3 (tre) pjestare të Komunitetit Serb .


Por nëse I referohemi ligjeve aktuale atij të Shërbimit Civil I zëvendësuar tashme me LIGJIN NR. 06/L - 114 PËR ZYRTARËT PUBLIKË të miratuar në Mars të vitit 2019 , Ku në Nenin 9 thotë decidivisht :

“Përfaqësimi i komuniteteve në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë” .

Që nëse I referohemi punsimit nga numri I përgjithshëm I pjestarëve të komunitetit Serb I cili ka (rreth 714 personave) dhe ka të punsuar rreth 15 persona me nivel të Shkollimi të Mesëm , në anën tjetër nga numri I përgjithshëm I Komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian (787 antare) vërehet një numër shumë më I vogël I punsimit me vetëm 3 personave në institucionet publike me nivel të arsimit të Mesëm dhe Universitar .

Bazuar në legjislacionin në fuqi , shihet qartë për një balancim jo të mirë të punsimit me dozë të diskriminim pozitiv ndaj punsimit të komunitetit Serbë .

REKOMANDOHEM : institucionet Komunale që të paktën 2-3 pjestatë nga rrjedhet e komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian , të gjindet modalitet për punsim në bazë të ligjit në fuqi , I cili do të reflektonte pozitivisht mbi inplementimin e ligjit në fjalë , dhe pozita e këtyre komuniteteve s’paku në shërbimin civil do të paraqiste ngritje , dhe do ta vlersonte komunën e Rahovecit si ndër komunat lidhe dhe të sukseshme në inplementimin e Ligjit mbi Shërbimin Civil .



PASOJAT E GJENDJËS SOCIALE :

Sa I përket çështjeve të tjera jetike që ballafaqohen komunitetet në Komunën e Rahovecit janë edhe shumë çështjet që ndërlidhen me jetën dhe gjenjës sociale , e që ka të bëjë me numrin shqetësues dhe të varur 100% të familjeve të komunitetve Rom , Ashkali dhe Egjiptian që janë barrë dhe përfitojnë nga skema programore sociale .

Si pasojë e shpjeguar tashmë nga shumë faktorë që rrjedhimisht I kontribuojnë rritjes së varfërisë së skajshem , duhet theksuar që edhe Ligji mbi përfitimin e skemës Sociale është diskriminuës , I cili ka reflektuar në disa situata shumë i brishtë dhe negativisht . Nëse I referohemi kriterëve të përcaktuara që ndërprejnë mbështetjen sociale me automatizëm në momentin që fëmija tejkalon 5 vite nga mosha etijë , Familjarët që janë të varur nga kjo asistencë risin numrin e lindjeve të fëmijëve edhe pse me kushte të rënda që vetëm e vetëm most ë largohën nga skema sociale , poashu referuar rregullores e cila me automatizem largon një përfitues të skemes sociale vetem pse punsohen në çfardo pune sezonale me afat të shkurtër është pasojë që ata hezitojnë të kërkojnë punë dhe varën nga kjo skemë sociale.

FEMIJET LËMOSHË KËRKUES :

Si pasojë e çështjes **Socio-Ekonomike** e cila në një mënyrë devijon nga hallkat të tjera zingjirore si pasojë e gjendjes , ajo ka ndikuar negativisht edhe tek shkelja e të drejtave të fëmijëve , ku edhe në Komunën tonë kemi hasur tek **Fëmijet Lëmoshë Kërkues** që vijnë nga komunitetet Rom , Ashkali dhe Egjiptian , e që sado që numri I tyre është I vogël (prej 5-6 fëmijë të identifikuar) .

Ky fenomen është vu në pah edhe do të trajtohet me prioritet nga ana e ZKKK-së , ku në bashkëpunim me Qendren për Punë Sociale dhe Drejtorinë e Arsimit në e Rahovecit do të marrë masa për kthimin e këtyrë fëmijëve në banka shkollore aty edhe ku e kanë vendin , dhe bazuar në obligimet që vijnë nga Ekipin për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin Parauniversitar , mekanizëm ky që është nxerrë me vendim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit , dhe dalur si obligim nga rregulloret në fuqi në bazë të udhëzimeve administrative të MASHT-it .



(Foto e realizuar gjatë faljës së Namazit të Xhumasë në oborrin e Xhamisë së“ Çarshisë”).

MBËSHTETJA ME NDIHMA SOCIALE PËR FAMILJET NË NEVOJË :

Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim , fatkeqsisht qëndron keq me buxhetin e vogël , të cilën kryesisht e ka të orjentuar në Investime kapitale , dhe pamundësia e zyrës për të intervenuar dhe mbështetur familjet e komuniteteve jo shumicë me ndihma eventuale ushqimore , veshembathje në nevojë , falë partnereve të sajë Ndërkombëtar, Vendor , nga institucione relegjioze dhe humanitare ka intervenuar ne disa raste me ushqim dhe veshëmbathje.

Pozicioni shoqëror, ekonomik dhe politik historikisht i disfavorshëm i këtyre tri komuniteteve (rom , ashkali dhe egjiptian) ka bërë që këto tri komunitete të përjetojnë pasojat e ngjarjeve të mësipërme duke jetuar në vendbanime të getoizuara , dhe me mbledhjen e matrialeve recikluese. Andaj **ZKKK** , në partneritet me organizatën Egjiptiane nga Gjermani , RAMSESS 2 përgjat vitit 2019 , kryesisht në festat fetare si Bajramit të Madh , Kurban Bajramit , dhe Muajit të shejntë Ramazan , ka mbështetur rreth **40 familje skamnore** si : Gra vetëushqyese , Përsona me Nevoja të Vecanta , Përsona të riatdhesuar me kushte skajshmerisht të dobëta me gjëra Ushqimore , Veshëmbathje dhe Mish Kurbanit në : **Lagja e Eperm , Fsh. Senoc , Xërxë , Dobidol , Gexë , Radostë , Ratkoc, Fortesë, Çifllak etj .**



KTHIMI I PËRSONAVE TË ZHVENDOSUR NGA : (SERBIA , MALI I ZI , MAQEDONIA E VERIUT) Programi RRK-V :

Kthimi i shumë qytetarëve e posaqërisht të komuniteteve nga kampet/vendbanimet jo formale të , Serbisë , Maqedonise dhe Malit të Zi , ende mbetet sfidë për Komunën e Rahovecit , pamundësia e mbështetjes së kësaj kategorie si pasojë e problemeve me alokim të tokës dhe krijimin e mundësive për tu kthyer në vendin e tyre të origjinës vazhdon të jetë problem . Komuna e Rahovecit vetëm gjat vitit 2019 ka trajtuar 16 Raste të familjeve që kanë bërë kërkesë për kthim në kuadër të programit RRK-V të mbështetur nga Ministria për Komunitete dhe Kthim , BE- ja (Bashkimi Evropian) dhe të implementuar nga organizata ndërkombëtare IOM .

Nga 16 familje në total sa janë trajtuar nga ZKKK-ja , vetëm 3 familje janë pjestar nga komuniteti Romë , ndërsa të tjerët janë nga komuniteti Serb .

Nga numri total i rasteve , 3 familje me rreth 15 anëtarë nga komuniteti Serb , të kthyer nga Serbia janë kthyer në vendin e origjinës , në Komunën e Rahovecit gjegjësisht në fshatin Hoqë e Madhe , ku në kuadër të programit RRK-V ju është ndërtuar shtëpia dhe benificione të tjera në bazë të programit (përfshi gjërat ushqimore, dru zjari etj) .

3 raste të tjera janë në procedurë për marrjen e Lejeve të ndërtimit dhe Pelqimit nga Këshilli i Fshatit Hoqë e Madhe , 7 raste të tjera janë të reja dhe janë në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit , momentalisht në mungesë të dokumentacioneve të plota për ta plotësuar lëndën sipas rregullorës në fuqi për personat e kthyer , pritën të shqyrtohen në ditët në vazhdim.

Ndërsa 3 raste të tjera të fundit që janë aprovuar për ndërtim të shtëpisë nga dy komisionet në nivel Lokal (Komunal) dhe Qëndror (Ministria) kanë mbetur pezull për trajtim dhe procedim në mungesë të truallit.

Gjat Nëntorit të vitit 2019 është nxerrë në fuqi Plani i Veprimit për Kthim të Qëndrushëm 2019-2021 dhe pritet të realizohet në përpikshmeri me rregullorën në fuqi për të kthyerit .



Dorzimi i shtëpisë për përfituesin : SPASOJE LUKIC - fsh. HOQË E MADHE



Nënshkrimi I Kontratës për të zhvendosurin mbrenda teritorit të Kosovës , zt.Nexhat Krasniqi .



Fillimi I ndërtimit të shtëpisë për zt. Milan Stanojevic

RIATDHESIMI (NGA VENDET E BE-së) :

Ndryshe nga kthimi, procesi I riintegrit të personave të riadhesuar nga vendet e BE-së gjatë këtij viti janë riadhesuar dhe paraqitur , bazuar në sistem SMR 24 raste nga komunitetit Shqiptar (të riadhesuar nga vendet europiane) 2 raste nga Komuniteti Rom , dhe 4 nga komuniteti Ashkali .


Bazuar në rregulloret dhe planin e veprimit për Kthim Të Qëndrueshëm për Personat e Riadhesuar , ka patur progres sa i përket zbatimit të shumë vendimeve , por për Kuvendin Komunal në Rahovec mbetet sfidë trajtimi i palëve në mungesë të kapaciteteve (resurseve humane) të ZKKK-së me staff të trajnuar në këtë drejtim dhe zyrtar Shqip folës .

Për këtë sfidë shumë vite më parë , me vendim të Ish-Kryetarit të Komunës zt. Idriz Vehapi , (rreth 6 vite më parë) , çështjet dhe trajtimi i personave të riadhesuarve është bërë nga Zyrja për të Drejtat e Njeriut , edhe pse trajtimi i personave në fjalë është bërë nga një digaster tjetër nuk ka munguar profesionalizmi në bazë të orjentimit sipas dokumentacioneve dhe rregulloreve në fuqi për integrimin e personave të riadhesuar .

Në këtë drejtim s'bashku me zyrën në fjalë , ZKKK-ë është në komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët deri pret në cdo moment në një prejdhë të të afërm të rritjes së kapaciteteve të zyrtarëve të ZKKK-së , të transferohen kompetencat nga Zyrja e të Drejtave të Njeriut në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim .

Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim -ZKKK , në bazë të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Mbrendshme MPB-së , dhe obligimeve që dalin nga MSA-ja, ka proceduar në Asamble Komunale të Komunës së Rahovecit , Planin e Veprimit për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar për vitin 2019-2022 .

Ky plani veprimit ka derivuar nga Strategjia dhe Rregulloret në fuqi mbi trajtimin e personave të riadhesuar , është aprovuar nga Komisioni për Hartimin e Planit të Veprimit në fjalë dhe nuk përmbajnë komplikime buxhetore në nivel komunal , por janë të bashkërenditura me kompetenca për implementim nga niveli qendror.



GJENDJA NË ARSIM NDAJ KOMUNITETET JO -SHUMICË:

Gjendja e përgjithshme në Arsim në komunën e Rahovecit , e posaqerisht tek komunitetet jo shumicë është relativisht e mire , si ndër segmente më jetike dhe me të nevojshëm për zhvillimin e pozitës së komuniteteve ,në këtë drejtim ka pasur progress por edhe sfida .

Duke ju referuar numrit të nxënësve që vijojnë mesimet në shkollat Filllore të Komunës sonë , numri I pjesmarrjes së tyre është i kënaqshëm , sidomos në venbasnimet ku jetojnë pjestarët e komuniteteve .

Sfide mbetet ende braktisja e shkollimit si pasoje e gjendjes së rëndë sociale , migrimit ilegal që tashmë është shpeshtuar , por edhe në raste specifike kur fëmijët kërkojnë lëmshë , raste këto të identifikuar kryesisht në vendbanime urbane ku jetojnë komunitetet.



Takimet me bazë në Komunitet (organizuar nga SHL KOSOVA) –Prindër , Fëmije , Institucione –SHFU “ Gëzim Hamza-Piktori” ,

Tema :

Fillimi I Fushatës sensibilizuese për regjistrimin me kohë të fëmijeve të komuniteteve ROM , ASHKALI DHE EGJIPTIAN në klacë të parë.

Qendrat e Arsimit me bazë në Komunitetet : që numerikisht janë dy në Komunën tonë dhe që menaxhohen kryesisht nga Organizatat jo Qeveritare si : **SHL KOSOVA** (Në Laxhën e Epërm) , dhe **OJQ-Voice of Rom, Ashkali and Egyptian** (Në fshatin Ratkoc) në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.



Në bazë të programit dhe korikulave të reja arsimore , kanë treguar rezultate shumë të mëdhaja për ngritjen e vetëdijës së shkollimit sidomos për pjestarët e komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian , përmes programeve në koordinim me MASHT-in , dhe programet e financuara nga Komisioni Evropian në kuadër të programit EUSIMRAES , ku janë realizuar fushata të shumta sensibilizuese për regjistrimin me kohë në klasë të parë në bashkëpunim me ZKKK-në dhe Drejtorinë e Arsimit , intervenimin në furnizimin e fëmijeve me matrial shkollor (Çanta , Fletore , dhe matriale didaktike shkollore) , Asistim në detyra të shtëpisë , mentorim , aktivitete psiko-sociale , aktivitete edukativo-argetuese që kanë rezultuar të sjellin rezultate në përmisimin e gjendjës në këtë segment ku drejtëpërdrejt kanë përfituar fëmijet e komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian .

SFIDË : Qëndrushmeria e këtyre qendrave me efektë shumë të madhë në komunitet ballafaqohet me mungesën e fondve për të operuar përmes programeve të veta , edhe pse MASHT-i ka nxërrë një udhëzim për t'i mbështetur ata në bashkëpunim me autoritetet komunale , ky dokument ende nuk ka gjetur zbatueshmeri , dhe njëri program I cili është menagjuar nga SHL KOSOVA në Korrik të vitit 2019 ka përfunduar programin , ndërsa programi I qendrës së komuniteteve në fshatin Ratkoc I menaxhuar nga OJQ-Voice of Roma , Ashkali & Egyptian , është duke punuar me orarë të përgjysmuar deri në fund të këtij viti.



SHKOLLIMI I MESËM DHE UNIVERSITAR, I Komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian gjatë vitit 2019 :

Vijushmeria e nxënësve në shkollat e mesme të larta mbetet ndër sfidat kryesore në këtë segment , në bazë të informatave të ZKKK-së në bashkëinformim nga Shkollat e Larta të mesme , vetëm 1 nxënës ndjek shkollën e mesme të lartë në zonën urbane , ndërsa 9 të tjerë në zonat rurale.

Gjithashtu në shtime Universitare në Komunën e Rahovecit vijon studimet vetëm 1 pjestarë I komunitetit Egjiptian në fshatin Brestovc .

ZKKK-ë në bashkëpunim me MASHT-in , Drejtorinë e Arsimit , dhe organizatat të tjera locale e ndërkombëtare , do të avokoj për mbështetje të këtyre kategorive , në stimulimin , dhe mbështetjen e tyre me Bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe universitare , duke ju referuar programit për ndarjen e bursave që dhurohen nga MASHT-I , Drejtoria e Arsimit në Rahovec , dhe programeve të tjera në këtë segment referuar dokumenteve strategjike si Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom , Ashkali 2017-2021 dhe Planit të veprimit në nivel komunal 2019-2021 .

Intervenimet e jashtme me kërkesë të ZKKK-së


Me kërkesë të ZKKK-së dhe partneritetit të mirëfillt me donatorët e jashtëm , janë bërë Intervenimet në mbështetje shtesë me material shkollor për vendbanimet që nuk kanë përfituar nga programet e tjera , me ndihmë të Shoqata Humanitare nga komuniteti Egjiptian në Gjermani - RAMSES 2 , në Komunën e Rahovecit (Lagjen e Epërm , Fsh.Xërxë , Senoc) janë shpërndarë 40 Çanta Shkollore , Material Didaktik , Fletore etj , për 40 nxënës .




FOTO : Shpërndarja : Lagja Epërm , Fsh. Xërxë , Senoc.

GJENDJA E ARSIMIT NË KOMUNITETIN SERBË – RAHOVEC :

Në komunën e Rahovecit vijojnë mësimet 142 nxënës në total të komunitetit Serbë , të cilën janë të kategorizuara si në vijim :



Në kuadër të numrit të institucioneve arsimore janë :



PERSHKRIM I DETAJIZUAR :

- Në Pjesën e Epërm në Rahovec : 1 (një) Çerdhe , 1 (një) Shkollë Fillore dhe 1 (një) Shkollë e Mame - Gjimnaz .
- Në fsht.HOQË E MADHE 1 (një) Çerdhe dhe 1 (një) Shkolle Fllore .

RENOVIMET E SHTËPIVE , NDRIÇIMI PUBLIK , INFRASTRUKTURA:

INTERVENIMI NË RENOVIM /STREHIM 8,857.50 Euro

Në kuadër të segmenteve të tjera jetike ku përfshihet Banimi/Strehimi , intervenimi në infrastrukturë dhe ndricimi public në vendbanimet e komuniteteve jo shumicë , ZKKK duke l'u

referuar buxhetit të sajë prej 30,000.00 Euro investime kapitale , ka mbështetur 5 familje të komuniteteve Rom , Ashkali , Egjiptian dhe Boshnjak , me matrial ndërtimor në bazë të vlersimit nga komisioni I ZKKK-së dhe Ingjinjeri I Komunës , ku kryesisht vlersim është bërë ndaj atyre familjeve që kanë pasur kushte të vështira sociale , shtëpi të vjetërsuara të dëmtuara nga lufta e fundit , apo faktori natyrë .

Përfituesit kanë përfituar matrial ndërtimor , kryesisht matrial ndërtimor të mjaftushëm për intervenimet në Çati , Lyerje , Fasadim ,Patos dhe cështje të tjera përcellëse .

Shuma totale e ndarjes së mjeteve është **8,857.50 Euro** , dhe është shpërndarë varsisht nga gjendja dhe dimenzionet që kanë poseduar shtëpitë , vlersim ky profesional nga ingjinjeri I komunës së angazhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike .

Përfituesit janë nga : Tre (3) nga Lagja e Epërm në Rahovec , Një (1) nga Fshati Dobidol , Një (1) nga fsht. Krushë e Madhe .



NDRIÇIMI PUBLIK ME PARTICIPIM KOMUNAL 5,810.00 Euro :

Në bashkëpunim me Organizatën IOM dhe Kuvendin Komunal Rahovec , janë mbështetur Fshati . Hoqë e Madhe , Lagja Multietnike në pjesën e Epërm , Fsh.Krushë me ndricim public në vëndbanimet e komuniteteve me rreth 50 llampa të reaja të tipit LED , ku pos përfshirjes së tyre janë renovuar edhe 50 të tjera në potë njetat vëndëbanimet .

Ndricimi public është intervenuar me 35 Llamba Sosh në Fsh. Hoqë e Madhe , 10 në Fsh.Krushe dhe 15 në Lagjen e Epërm .

Ky Projekt ka kushtuar në terësi me **11,810.00** në total përfshirë edhe shpenzimet administrative , dhe është participuar me vlerë prej 5,810.00 nga Komuna e Rahovecit .



INFRASTRUKTURA RRUGORE /KUBËZIMI :

Në bazë të kërkesave dhe nevojave për të intervenuar në infrastrukturën Rrugore gjegjësisht me kubëzimin dhe renovimin e rrugëve e rrugicave në vendbanimet ku jetojnë pjestarët e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Rahovecit , janë identifikuar disa prej tyre , por duke u bazuar në buxhëtin e vogël që ka zyrja , ZKKK në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike , Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Kryeministrit -ZÇK, dhe MAPL-së , do të intervenoj në disa vendbanime të planifikuara , projekti momentalisht është në fazën e vizibilitetit , dhe pritet të procesohet në prokurimim pëe tenderim .

Projekti do filloj këtë vitë 2019 dhe pritet të përfundoj në vitin 2020 në tërësi(PROJEKT 2 VJEQAR) dhe dotë kapë koston prej rreth 70,000 €, përshkak të limitit buxhetor të vogël mbështetja do të bëhet me mjete buxhetore edhe nga ai I alokuar të vitit 2020.

Kubezim :

- Fsh. Hoqë e Madhe – ZKKK , Drejtoria e Shërbimeve Publike , ZÇK.
- Fsh. Xërxë (rruga HASI) ZKKK
- Fsh Çifllak - ZKKK & Drejtoria e Shërbimeve Publike .

- Fsh. Zoqishte (ku shpien tek Kisha e Manastirit Serbe)
- Rruga: Lazar Kujndzhiq

Sanim /Renovim :

- Renovimi I 4 rrugicave në Lagjën e Epërm në vendbanimet e banuara nga komuniteti Serb , Rom , Ashkali , Egjiptian dhe Boshnjak etj .



MBËSHTETJA E PROGRAMIT PËR STABILIZIM NGA IOM-i :

Në kuadër të këtij programi i cili ka për qëllim të zhvillojë pozitën ekomunikative të pjestarëve të komuniteteve jo shumicë në komunën tonë , kanë përfituar 2 pjestarë të komunitetit Serb nga fshati Hoqë e Madhe , me paisje dhe vegla punë si :

Multikultivator dhe Pajse të Zdruktharië :



MIRATIMI I PLANËVE TË VEPRIMIT NË KOMITETIN PËR POLITIKE DHE FINANCA DHE KOMUNITETE.

- **Plani Komunal I Veprimit Për Të Zhvendosurit Dhe Zhgjidhje Të Qëndrushëm .**
- **Plani Komunal Për Ri Integrimin E Qëndrueshëm Te Personave Të Riatdhesuar 2019 – 2022**
- **Plani Lokal I Veprimit Për Përfshirjen E Komuniteteve Rom, Ashkali Dhe Egjiptian Në Komunën E Rahovecit 2019-2021**

PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR PËRSONAT E ZHVENDOSUR DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUSHËM 2019-2021.

Ky Plan Komunal i Veprimit (PKV), konfirmon përkushtimin dhe vullnetin politik të Komunës së Rahovecit për ofrimin e mjedisit të sigurt dhe mundësinë e kthimit e të gjithë qytetarëve, të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, pa dallim etnie, fesë dhe përkatësisë politike. Konsideratë e veçantë do t'i kushtohet integritetit socio-ekonomik gjatë hartimit të planit të veprimit i cili do ti përgjigjet aftësive aktuale të familjeve të kthyer në mënyrë që të sigurohet zgjidhja e qëndrueshme e të kthyerve.

BAZA & ARSYESHMËRIA E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT

Ky plan veprimi ka për qëllim ta ndihmojë Komunën në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të ri-integritetit në bazë të Rregullores (QRK) – Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe Rregullores nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, në bazë të kërkesës për asistencë për kthim vullnetarë nga personat e zhvendosur dhe vlerësimit të nevojave specifike sipas sistemit të menaxhimit të të dhënave.

PLANI KOMUNAL PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TE PERSONAVE TË RIATDHESUAR 2019 – 2022

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integritetit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë së Ri integritetit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri integrim të qëndrueshëm për Komunën e Rahovecit.

BAZA & ARSYESHMËRIA:

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për

realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë së Ri të integritit dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPR si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e origjinës, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është i bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, në këtë Plan është mundur integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e origjinës.



PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOMUNËN E RAHOVECIT 2019-2021

Në vitin 2016, Zyra për Qeverisje të mirë (ZQM/ZKM) në Zyrën e Kryeministrit ndërmori iniciativën për hartimin e strategjisë së re për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare. Pas një procesi të gjatë gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë akterët, në prill të vitit 2017, është aprovuar Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.

Për të ndihmuar zbatimin e kësaj Strategjie dhe për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Komuna e Rahovecit, me përkrahjen e donatorëve, ka iniciuar procesin e hartimit të Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit 2019-2021.

Në përputhje me Marrëveshjet e Bashkëpunimit me donatorët përkatës, Komuna e Rahovecit dhe donatorët, kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm, përkatësisht, themelimin e Grupit punues

nga Komuna dhe caktimin e punëtorive që janë përkrahur nga Projekti KEEN - Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim dhe caktimin e konsulentit nga Projekti KOSINT - Iniciativa e Kosovës për Integrim, për të ndihmuar procesin.

Sipas statistikave nga regjistrimi i popullsisë i bërë në vitin 2011¹, dhe të konfirmuara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK në komunën e Rahovecit jetojnë 787 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në komunën e Rahovecit, banorët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë kryesisht në qytetin e Rahovecit (rreth 260 pjesëtarë), dhe me numër më të madh në fshatrat: Xërxë, Ratkoc, Krushë e Madhe, Dabidol, Çifllak, Celinë etj



SFIDAT E KOMUNITETIT DHE BASHKËPUNIMET E ZKKK-së :

Si sfidë tjetër e fundit për këtë vit ishte edhe migrimi relativisht i madh i pjesëtarëve të komuniteteve, ku sipas informative jo formale të ZKKK-së në Komunën e Rahovecit e kanë lëshuar vendin rreth 130 – 150 persona nga komuniteti Rom , Ashkali dhe Egjiptian , të cilët mësyen drejt vendeve të Evropës perëndimore jo për qështje sigurie por për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike, e që si fenomen po vazhdon edhe me komunitetin shumicë Shqiptar.

Përveç sfidave kishte edhe kremtime dhe suksese , vlenë të theksohet se nga festat që konsiderohen memorial për komunitete , tradicionalisht edhe këtë vit është mbështetur aktiviteti i turnirit sportive në fsh.Hoqë e Madhë për nderë të Pashkeve Ortodokse nga komuniteti Serb .



Ky vit karakterizohet edhe me forcimin dhe fillim bashkëpunimin e ri me partnerët nacional qëndror , lokal e organizata ndërkombëtare donatore siç është : ZÇK ,MAPL,MKK, Organizata SHL Kosova , KEEN , Balkan Sunflower , VORAE , RAMSESS 2 , AL BATUL , ADVANCING TOGETHER , Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) , OSCE; UNMIK; etj.

KËSHILLAT DHE REKOMANDIMET PËR EKZEKUTIVIN KOMUNAL DHE AUTORITETET PËRFAQËSUESE:

Për Kryetarin e Komunës së Rahovecit

- Të zgjidhet çështja e kthimit të personave të zhvendosur nga Serbia , të cilët kanë shprehë dëshirën për tu kthyer në vendin e tyre të origjinës, përkatësisht të rritët bashkëpunimi më konstruktiv me Drejtorinë e Katastrit , dhe Urbanizmit , si dhe të përshpejtohen procedurat për leje të ndërtimit për personat të zhvendosur;

- Të përkrah Implementimin e planit lokal të veprimit lidhur me Riintegrimin e personave të riatdhesuar 2019 -2022;
- Të përkrah Implementimin e planit lokal të veprimit lidhur me Kthim të Qqëndrushëm për personat e Zhvendosur 2019 -2021;
- Të përkrah Implementimin e planit lokal të veprimit Rom , Ashkali dhe Egjiptian 2019 -2021;

Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim :

- Të fillojë ndërtimin e shtëpive të personave të zhvendosur në Serbia si dhe personat e zhvendosur brenda vendit .
- Të rrisë bashkëpunimin si dhe koordinimin me ZKKK-në;
- Të fillojë bashkëpunimi I projekteve të tjera , rreth ndërtimit , renovimit të shtëpive të komuniteteve jo shumicë jashtë programit të Kthimit .

Për Ministrinë për Punë të Brendëshme :

- Të zbatohen të gjitha vendimet e Komisionit Qëndrorë lidhur me planet e bizneseve etj.
- Të bëjë decentralizimin e fondit për riintegrim ashtu siq ishte përcaktuar nga MBP ;
- MPB në bashkëpunim me komunën të shikojë mundësitë e ndërtimit të banesave kolektive për familjet e riatdhesuar të cilët nuk kanë shtëpi apo banesë në pronësi të tyre;

TRAJTIMI I PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE GJATË VITIT 2020

- Implementimi I Planit lokal të veprimit lidhur me Riintegrimin e personave të riatdhesuar 2019 -2022;
- Implementimi I Planit lokal të veprimit lidhur me Kthim të Qqëndrushëm për personat e Zhvendosur 2019 -2021;
- Implementimi I Planit lokal të veprimit Rom , Ashkali dhe Egjiptian 2019 -2021;
- Vazhdimi I intervenimeve në infrastruktruë në vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë si vazhdimi e punës nga viti 2019-2020 .

AKTIVITETET ZKKK-së , ZYRTARËVE TË SAJË :

Z.K.K.K. ka realizuar dhe pritur disa vizita , me qëllim të bashkëpunimit më konstruktiv në theks të vecantë : Promovimit , Mbrojtjes dhe Zhgjidhjes së problemeve të Komuniteteve :

1. Qendra Rinore SHL KOSOVA , e cila menagjon programin e arsimit në ndihmë të detyrave të shtëpisë për nxënësit e komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian .

2. Vizitë në Fshatin Hoqë e Madhe (gjendja e komunitetit Serb)
3. Vizitë Fshati Krushë e Madhe (gjendja në infrastruktur) .
4. Fsh.Xërxe (gjendja në infrastruktur) .
5. Fsh.Senoc (gjendja sociale dhe infrastruktura) .
6. Vizitë në stacionin e Policisë së Kosovës –Rahovec (gjendja e sigurisë dhe çështjet ndëretnike) zt.Osman Ismaili –Komandant .
7. Vizitë pune në Ministrinë e Punës dhe Mirqenjes sociale –zv.Ministër
8. zt.Besart Jashari (ndërtimi dhe renovimi I shtëpive për komunitetet rom , ashkali dhe egjiptian në nevojë) .
9. Vizitë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim zv.Ministër Qazim Rahmani (ndërtimi , renovimi dhe paisja me material ndërtimor për shtëpitë komuniteteve në nevojë) .
10. Vizitë në Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rajonal zv.minister zt. Jeton Emini (subvecionimi I fërmerëve të komunitetit , blegëtorve etj) .
11. Vizitë në Ministrinë Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë zv.Ministër Muhamet Kelmendi .
12. OJQ-Voice of Roma , Ashkali and Egyptian –Drejtor Ekzekutiv Isak Skenderi (mbështetja në hartimin e planit të veprimit për komunitetet Rom , Ashkali dhe Egjiptian) .
13. Vizitë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal – Ministër zt.Rasim Demiri (Mbështetja e komuniteteve jo shumicë me grantë për zhvillim dhe Start Up biznese).
14. Vizitë pune në Zyren për Çështje të komuniteteve , Drejtor zt. Ivan Milojevic. (mbështetja në infrastruktur , ndërtim të shtëpive , mbështetja në rastet shëndetsore , mbështetja në aktivitetet kulturore , promovimi I ditëve nacionale të komuniteteve , mbështetja e praktikës me pagesë etj) .
15. Këshilli Konsultativ për Komunitete –Zyrja e Presidentit të Republikës së Kosovës – Berhil Shasivari .
16. Zv.Ministri I MAPL-së zt.Bashkim Krasniqi .
17. Caritasi Zviceran .
18. Fondacioni CREATE .
19. Ojq- Advancing Together .

PUNTORITË , TRYEZAT E RUMBULLAKËTA, GRUPET PUNUESE :


1. Zyrtarët e ZKKK-së kanë marrë pjesë në puntorinë 2 ditore - **“Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të mekanizmave për mbrojtje të komuniteteve lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre”**. mbështetur nga OSCE - Pejë.
2. Zyrtarët e ZKKK-së , kanë marrë pjesë **“Tryezë për promovimin e komiteteve komunale vepruese dhe funksionimi i tyre”**. Organizuar nga OSCE .



3. **Pjesmarrja e stafit në tryezën e rrumbullakët me rrjetin Qeliza - me temën “Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore”.**



4. Është realizuar takim konsultativ me karakter bashkëpunimi , në mes të Organizatës ndërkombëtare – YMCA , me focus Rolin dhe Rëndësinë e zhvillimit të të rinjeve dhe bashkëpunimit ndëretnik .



5. Zyrtarët e ZKKK-së , kanë marrë pjesë në puntorinë konsultativë mbi gjendjen e të kthyerve dhe bashkëpunimit midis institucioneve Lokale dhe Qendrore-organizuar nga UNMIK.



6. Panairin I promovimit të kulturave të komuniteteve jo shumicë, në kuadër programit “CULTURACT”.



7. Në Bashkëpunim me Organizatën VORAE & KEEN , është realizuar puntoria e parë për draftimin e Planit të Veprimit për komunitetet Rom , Ashkali dhe Egjiptian 2019-2021



8. Tryezë e rrumbullakët “Gjendja edhe të drejtat e grave në Rahovec” .



9. Z.K.K.K ka marrë pjesë në 6 takime të Komitetin për Siguri në Bashkësi .



10. Z.K.K.K – ka marrë pjesë në 6 mledhje të Komitetit për Komunitete, dhe ka raportuar për gjendjen e komuniteteve dhe projekteve në process .



11. Z.K.K.K – ka marrë pjesë në mbi 35 mledhje me Kryetarin e Komunës zt. Smajl Latifi dhe I ka raportuar për gjendjen e komuniteteve dhe aktivitetet e Zyrës .



Aktivitetet të tjera jashtë këtij raporti , janë të përfshira në raportet periodike 3 mujore , në Web Faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

Lendrit Qeli, Juridipi
Shef i ZKKK-së

A circular official stamp of the Municipality of Rahovec, Republic of Kosovo. The text around the border reads "REPUBLIKA E KOSOVES", "Komuna e Rahovecit", "RAHOVEC", "IX", "ORAHOVAC", "Opština Oranovac", and "REPUBLIKA KOSOVA". A signature is written across the stamp.